FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 48	**2002**	**Gusht**

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.8926 datë 22.7.2002 — Për formën dhe përmasat e Flamurit Kombëtar, përmbajtjen e Himnit Kombëtar, formën dhe përmasat e Stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre……. 1423

L I G J
Nr.8926, datë 22.7.2002

PËR FORMËN DHE PËRMASAT E FLAMURIT KOMBËTAR, PËRMBAJTJEN E HIMNIT KOMBËTAR, FORMËN DHE PËRMASAT E STEMËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË TYRE

Në mbështetje të neneve 14, 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Neni 2
Përkufizime

1. Flamuri kombëtar dhe himni kombëtar janë simbole kombëtare.
2. Stema e Republikës së Shqipërisë është simbol shtetëror.

Neni 3
Format dhe përmasat e flamurit kombëtar

1. Flamuri kombëtar paraqet një fushë me ngjyrë të kuqe gjaku, me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes, me krahë të hapur anash. Secili nga krahët e shqiponjës ka nëntë pendë, ndërsa bishti ka shtatë pendë.
2. Përmasat e flamurit kombëtar përcaktohen në raportin 1 me 1,4 njësi.
3. Pamja e flamurit kombëtar, fortësia e ngjyrave të tij dhe raportet janë ato të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 4
Përdorimi i flamurit kombëtar

1. Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të mbajë, të ngrejë ose të përdorë flamurin kombëtar.
2. Të gjitha institucionet publike detyrohen të vendosin flamurin kombëtar në mjediset e tyre të brendshme dhe të jashtme. Në këto institucione ndalohet ngritja ose vendosja e flamurëve të huaj, me përjashtim të rasteve të pritjeve ose të ceremonive protokollare dhe të solemniteteve të tjera, të parashikuara në ligj, por gjithmonë të shoqëruara nga flamuri kombëtar. Në këtë rast flamuri kombëtar nuk mund të jetë në përmasa më të vogla se flamurët e tjerë.
3. Flamuri kombëtar përdoret në rastet e takimeve ceremoniale të institucioneve shtetërore me përfaqësues të shteteve të huaja; në mënyrë të lirë në tryezat e punonjësve në institucionet shtetërore dhe nga persona juridikë; në godinat dhe autoveturat e përfaqësive të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në të gjitha rastet kur Shqipëria përfaqësohet

zyrtarisht si palë. Flamuri kombëtar, gjithashtu, përdoret në raste kur, për arsye ligjore, ngrihet një flamur i huaj. Flamuri kombëtar vendoset në vendin më të dukshëm ose në të njëjtin vend ku vendosen flamurët e tjerë.

4. Në rast zie kombëtare, të shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave, flamuri kombëtar ngrihet në gjysmështizë.

5. Mënyra e përdorimit të flamurit kombëtar në mjediset e jashtme e të brendshme, të përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, si dhe raporti i përmasave të tij për këto mjedise, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5
Himni kombëtar

1. Himni kombëtar i Republikës së Shqipërisë është "Rreth flamurit të përbashkuar".

2. Përmbajtja e tekstit të himnit kombëtar paraqitet në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Partitura e himnit kombëtar shqiptar paraqitet në shtojcën nr.3, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 6
Përdorimi i himnit kombëtar

1. Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të këndojë himnin kombëtar.

2. Himni kombëtar këndohet dhe interpretohet në ceremonitë zyrtare, të parashikuara në protokollin e shtetit, si dhe në çdo veprimtari tjetër ndërkombëtare, ku vendi ynë është palë. Kur interpretohet himni kombëtar, merret drejtqëndrim.

3. Në ceremonitë solemne, festive dhe të përfaqësimit kombëtar, interpretohen vetëm strofa e parë dhe refreni i himnit kombëtar. Kur himni kombëtar interpretohet së bashku me himnin e një vendi tjetër, përparësi ka ky i fundit.

Neni 7
Format dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë

1. Stema e Republikës së Shqipërisë është simbol shtetëror. Ajo paraqet një shqyt, me ngjyrë të kuqe gjaku, me një shqiponjë në qendër, të njëjtë me shqiponjën e flamurit kombëtar të Republikës së Shqipërisë. Në krye të shqytit, me ngjyrë të artë, është vendosur përkrenarja e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, në profil djathtas. Përmasat e shqytit janë në raportin 1 me 1, 5 njësi.

2. Pamja e stemës së Republikës të Shqipërisë, fortësia e ngjyrave dhe raportet janë të përcaktuara në shtojcën nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 8
Përdorimi i stemës së Republikës të Shqipërisë

1. Stema e Republikës së Shqipërisë mbahet dhe përdoret vetëm nga institucionet e pushtetit qendror. Stema vendoset në hyrjen kryesore të institucionit, mbi emërtimin e tij.

2. Stema e Republikës së Shqipërisë vendoset në vulat e institucioneve shtetërore, në aktet e tyre zyrtare, mbi emërtimin zyrtar të institucioneve shtetërore dhe në çdo akt tjetër, që institucioni shtetëror u drejton të tretëve. Stema e Republikës së Shqipërisë përdoret si shenjë identifikimi në mjetet e punës së institucionit shtetëror dhe në mjediset e punës.

3. Stema e Republikës së Shqipërisë, kur paraqitet e shoqëruar me stema shtetesh të tjera,

vendoset në vendin më të dukshëm ose në të njëjtin vend me to.

4. Mënyra e përdorimit të stemës së Republikës të Shqipërisë, si dhe raporti i përmasave të saj, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3417, datë 31.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 9. 8. 2002
Doli nga shtypi më 10. 8. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë